

VENDIM
Nr.692, datë 10. 11.2005

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SË RIPUNUAR “KONSOLIDIMI I NJË SISTEMI
PLANIFIKIMI TË INTEGRUAR NË SHQIPËRI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Miratimin e strategjisë së ripunuar “Konsolidimi i një sistemi planifikimi të integruar në Shqipëri”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2.Krijimin e komitetit ndërministror të planifikimit strategjik, të kryesuar nga Kryeministri, për:

- miratimin e drejtimeve kryesore të strategjisë së zhvillimit të vendit;
- përcaktimin dhe miratimin e prioritetëve të qeverisë;
- përcaktimin dhe miratimin e kornizës së planifikimit të borxhit afatmesëm;
- përcaktimin strategjik të tavanëve buxhetore, në funksion të prioritetëve të qeverisë;
- bashkërendimin strategjik të ndihmës së huaj me komunitetin e donatorëve.

3. Krijimin e komitetit ndërministror të modernizimit të qeverisë, të kryesuar nga zëvendëskryeministri, për:

- sigurimin e procesit teknik të përgatitjes së dokumentacionit të strategjisë kombëtare dhe të bashkërendimit të strategjisë me donatorët;
- sigurimin e bashkërendimit efektiv të programit të modernizimit të qeverisë;
- sigurimin e ngritjes së kapaciteteve dhe të strukturave, në përputhje me rekomandimet e strategjisë “Konsolidimi i një sistemi planifikimi të integruar në Shqipëri”.

4.Përbërja e komitetit ndërministror të planifikimit strategjik dhe e komitetit ndërministror të modernizimit të qeverisë të përcaktohen me urdhër të Kryeministrit.

5.Procesi teknik i bashkërendimit të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social, i hartimit të strategjisë së asistencës së huaj e bashkërendimit me programet e donatorëve dhe i zbatimit të sistemit të planifikimit të integruar të kryhet nga strukturat përgjegjëse në Këshillin e Ministrave.

6.Funksionet e investimeve publike, përfshirë edhe ato të asistencës së huaj, të kryhen nga Ministria e Financave.

7. Vendimi nr. 244, datë 21.4.2005 i Këshillit të Ministrave “ Për miratimin e strategjisë “Konsolidimi i një sistemi planifikimi të integruar”” dhe çdo normë që bie ndesh me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha